



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TE UJERAVE TE NDOTURA
KOMISIONI KOMBETAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr. 13, datë 23.02.2016

**PËR LICENCIMIN E OPERATORËVE DHE MIRATIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMIT UK DERI NË PËRFUNDIM TË PROCEDURAVE TË RIORGANIZIMIT
TË SHOQËRIVE UK**

Në zbatim të nenit 14, gërma “e” dhe “i”, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, për “Kudrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator, duke patur në konsideratë periudhën kohore që ju nevojitet njësisive të qeverisjes vendore dhe shoqërive UK për përfundimin e procedurave të riorganizimit, sipas reformës administrative territoriale,

VENDOSI:

1. Shoqëritë ujësjellës-kanalizime të cilave ju përfundon afati i licencës përpara se të përfundojë riorganizimi i tyre, sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", duhet të aplikojnë pranë ERRU për rinovimin e licencës ekzistuese;
2. Shoqëritë UK që përfundojnë procedurat e riorganizimit, të aplikojnë brenda tre muajve pranë ERRU për pajisjen me licencë të re shërbimi;
3. Shoqëritë UK do të përdorin tarifat e shërbimit UK të miratuara nga ERRU për zonën e shërbimit sipas licencës ekzistuese të lëshuar nga ERRU, deri në përfundim të procedurave të riorganizimit;
4. Për zonat e reja të cilat janë në proces të kalimit nën administrim të shoqërive UK, deri në miratimin e tarifave pranë ERRU, do të zbatohen tarifat që janë aplikuar në këto zona, përpara përfundimit të reformës territoriale;
5. Brenda tre muajve nga përfundimi i procedurave të riorganizimit, shoqëritë duhet të aplikojnë pranë ERRU për miratimin e tarifave të shërbimit UK.

6. Paraqitja e aplikimit për miratimin e tarifave dhe procedura për miratimin e tyre do të kryen në përputhje me nenin 22 të ligjit 8102 datë 28.03.1996 " Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:

Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator, nr 39 datë 09.12.2015 "Për miratimin politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura" ;

Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator, nr 42 datë 09.12.2015 Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujrave të ndotura";

Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator, nr 40 datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujrave të ndotura";

Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator, nr 41 datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujrave të ndotura";

7. Shoqëritë duhet të marrin masat e nevojshme për përfundimin sa më shpejt të procedurave të riorganizimit dhe pasqyrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të ndryshimeve të statusit juridik dhe zonës së shërbimit;
8. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë ujësjellës-kanalizime;
9. Ndjekin zbatimin e këtij vendimi të gjitha strukturat e ERRU, sipas përkatësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Avni Dervishi